

VENDIM
Nr.1076, datë 29.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1282, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTËN E PRANIMIT DHE TARIFËN E SHKOLLIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE SPECIALIZUESE
AFATGJATA, NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS,
PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 pika 1.3.2, 34, 35 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr.1282, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kuota e pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve specializuese afatgjata, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës, të jetë 345, e ndarë në specialitete, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Kuotat e paplotësuara rishpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universitetit i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SHTOJCA NR.1

KUOTA E PRANIMIT NË STUDIMET SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FAKULTETIN E
MJEKËSISË TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Nr.	Programi i specializimit	Ministria e Shëndetësisë	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Drejtësisë	Trojet shqiptare	Kuota të pambuluara	Shuma
1.	Alergologji	3	-	-	-	3	6
2	Anatomi patologjike	1	-	-	-	5	6
3.	Anestezi-reanimacion	17	-	-	1	-	18
4.	Dermatologji	11	-	-	-	-	11
5.	Endokrinologji	7	-	1	1	1	10
6.	Gastrohepatologji	2	-	-	-	4	6
7.	Hematologji	4	1	-	-	2	7
8.	Diagnozë me imazhe	6	3	-	-	-	9
9.	Kardiokirurgji	5	-	-	-	-	5
10.	Kardiologji	5	-	2	1	4	12
11.	Kirurgji e përgjithshme	10	2	-	1 (Preshevë)	2	15
12.	Kirurgji maksilo-faciale	5	-	-	-	-	5
13.	Laborator klinik-biokimik	2	1	1	1 (Preshevë)	3	8
14.	Mikrobiologji	4	-	-	1	2	7
15.	Mjek familje	9	-	-	4	12	25
16.	Mjekësi interne	10	2	-	1	6	19
17.	Mjekësi ligjore	-	-	-	-	5	5

18.	Nefrologji	-	2	-	-	6	8
19.	Neurologji	1	1		-	4	6
20.	Neurokirurgji	5	2	-	1	1	9
21.	ORL	2	-	1	2 (Preshe.)	-	5
22.	Obstetrikë — gjinekologji	6	-	-	1 (Preshe.)	5	12
23.	Okulistikë	2	-	-	-	3	5
24.	Onkologji	3	-	-	1	6	10
25.	Ortopedi- traumatologji	1			1	5	7
26.	Pediatri	21	-	-	1	2	24
27.	Pneumonologji	-	1	-	1	8	10
28.	Psikiatri	1	1	2		2	6
29.	Psikiatri e fëmijëve dhe e adoleshentëve				1	5	6
30.	Reumatologji	10	-	-	-	2	12
31.	Sëmundje infektive	6	-	-	1	3	10
32.	Shëndet publik	10	2	-	-	-	12
33.	Terapi stomatologjike	2				4	6
34.	Toksikologji klinike	-	-	-	-	5	5
35.	Pediatri (e specializuar në okulistikë pediatrike, ORL pediatrike, ortopedi pediatrike)	6	-	-	-	-	6
36.	Mjek urgjence	12	-	-	-	-	12
	Gjithsej	189	18	7	21	110	345